

VENDIM
Nr.693, datë 12.10.2011

PËR LICENCIMIN E AKADEMISË SË STUDIMEVE TË APLIKUARA, Durrës

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 pika 2, 43, 44 dhe 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Licencimin e Akademisë së Studimeve të Aplikuara, Durrës, në emër të shoqërisë “Talenti”, sh.p.k., e cila do ta ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Durrësit.
2. Akademia e Studimeve të Aplikuara, Durrës, do të organizohet në katër fakultete:
 - a) Fakulteti i Shkencave të Aplikuara, që do të ofrojë programet e studimit të ciklit të parë në:
 - i) Menaxhim biznesi;
 - ii) Financë.
 - b) Fakulteti i Shkencave të Edukimit, që do të ofrojë programet e studimit të ciklit të parë në:
 - i) Mësuesi për arsimin fillor;
 - ii) Mësuesi për arsimin parashkollor.
 - c) Fakulteti i Shkencave Shoqërore, që do të ofrojë programet e studimit të ciklit të parë në drejtësi.
 - ç) Fakulteti i Shkencave Mjekësore, që do të ofrojë programet e studimit të ciklit të parë në infermieri.
3. Akademia e Studimeve të Aplikuara, Durrës të ofrojë programet e studimit të ciklit të parë, me kohëzgjatje 3 (tre) vite akademike dhe me realizimin e, së paku, 180 krediteve. Në përfundim të këtyre programeve të studimit lëshohet diplomë e nivelit të parë “Bachelor” në:
 - a) Menaxhim biznesi;
 - b) Mësuesi për arsimin fillor;
 - c) Mësuesi për arsimin parashkollor;
 - ç) Financë;
 - d) Drejtësi;
 - dh) Infermieri.
4. Akademia e Studimeve të Aplikuara, Durrës ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës. Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.
5. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.
6. Akademia e Studimeve të Aplikuara, Durrës, duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.
7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha